



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA POLIÇAN

Nr. \_\_\_\_\_ Prot

Poličan , me 22.04.2024

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje pajisje mobilerie arsimit bazë .**

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 39150000-8-  
Mobilje dhe pajisje të ndryshme

**VLERA E FONDIT LIMIT:**

Fondi limit/vlera e pritshme e kontratës: 2 305 767 (dy milion e treqind e pesë mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e shtatë leke) pa tvsh **Monedha, pa TVSH.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” ndryshuar me ligjin 16/2024, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Polican, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP ndryshuar me ligjin 16/2024, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

*Kriteret e mesiperme jane vendosur ne perputhje me Nenin 82 "Formulari permbledhes i vetdeklarimit" dhe Neni 83 "Sigurimi i ofertes", te Ligjit Nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik" si dhe ne mbeshtetje te nenit 30, pika 1, te VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik: citojme Neni 83 i LPP "Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël", Neni 82, i LPP "1. Bashke me dorezimin e kerkesave per pjesemarrje ose te ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojne si prove paraprake ne vend te disa vertetimeve te leshuara nga autoritetet publike ose pale te treta, formularin permbledhes te vetdeklarimit, sipas parashikimeve te ketij ligji. Permbajtja e ketij formulari percaktohet ne rregullat e prokurimit publik".*

## **2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

### **2.1. Përshatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):**

*Referuar pikës 1 të shtojcës 8, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 8.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP ndryshuar me ligjin 16/2024, nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, si dhe shtojcës 8 të DST-së.

### **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1** Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim, për xhiron vjetore për vitet financiare 2020, 2021, 2022 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 40 % e fondit limit të kontratës objekt prokurimi.** (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse Operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga Autoriteti Kontraktor).

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP ndryshuar me ligjin 16/2024, si dhe nenin 55, pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 29, te Ligjit Nr. 8438, dt. 28.12.1998 "Për Tatimin mbi të Ardhurat", i ndryshuar, ku përcaktohet: *Çdo tatimpagues pergatit deklaraten vjetore te te ardhurave te tatueshme ne formen e percaktuar ne udhezimin e Ministrit te Financave ne zbatim te ketij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaraten vjetore ne organet tatimore **brenda dates 31 mars te vitit pasardhes***".

**2.2.2** Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2024 sipas kësteve të parashikuara në ligjin nr.9632 datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar;

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë se kanë paguar detyrimet e taksave vendore për vitin 2024 sipas kësteve të parashikuara në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të DST-së objekt prokurimi.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

**Shënim:** Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar duhet të dorëzojë pranë AK, **përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit**, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP ndryshuar me ligjin 16/2024, si dhe nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave Vendore" i ndryshuar, në ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 "Per procedurat tatimore" i ndryshuar, neni 4, pika 2 d).

Referuar sa mësipër, njësia e prokurimit gjykon se kriteri i vendosur nga autoriteti kontraktor lidhur me vetëdeklarimin nga ana e operatorëve ekonomikë të vërtetimit të shlyerjes së detyrimeve vendore për vitin 2024 sipas prane bashkise/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për "Sistemin e Taksave Vendore" i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për tju nënshtruar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

**2.2.3.** Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2021, 2022, 2023, të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të Ligjit Nr.10091 datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar" të ndryshuar.

Kjo kërkesë për kualifikim, konsiderohet e përmbushur nëse në bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht plotësohet nga secili anëtar i bashkimit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, ndryshuar me ligjin 16/2024 si dhe nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" si dhe Ligjit Nr.10091 datë 05.03.2009 "Për auditimin

ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar” te ndryshuar. Kjo kërkesë për kualifikim, konsiderohet e përmbushur nëse në bilanci e dy viteve të njëpasnjëshme nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

### **2.3. Aftësitë teknike dhe profesionale:**

**2.3.1.** Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20% të vlerës së përlogaritur fondit limit që prokurohet.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77/4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” ndryshuar me ligjin 16/2024 dhe nenit 55, pika 4 germa b) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën me sukses, prandaj është kërkuar që kontratat e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufirit të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

**a)** Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Vlera e parashikuar e kontratës, është nën kufirin e ulët monetar. Vlera për furnizime të ngjashme përbën një nivel të mjaftueshëm përvojë duke patur parasysh objektin dhe vlerën e fondit limit.

---

Përvoja e mëparshme është një element shumë i domosdosshëm që garanton autoritetin kontraktor se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së kontratave të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Në mbështetje të nenit 88 pika 1 e VKM 285/2021, parashikon se “Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.

**2.3.2. a.** Në rast se ofertuesi ekonomik është prodhuesi mobiljeve të drurit duhet të ketë të punësuar një staf punonjesh prej të paktën 6 (gjashtë) personave, për periudhën e muajit të fundit të deklaruar. Me qëllim plotësimit të këtij kriteri, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetim nga Administrata Tatimore, shoqëruar me listëpagesat e periudhës së kërkuar (të firmosura dhe vulosura nga Administrata Tatimore/ në mënyrë elektronike në përputhje me legjislacionin në fuqi)

Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar staf teknik për realizimin e procedurës së prokurimit, të vërtetuar me kontratë punë të vlefshme dhe dëshmi përkatëse lëshuar nga institucione të akredituara, nga autoritetet përgjegjëse shtetërore gjithashtu dhe dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik, (të vlefshme) lëshuar nga Inspektoriat Shtetëror Teknik dhe Industrial apo nga subjekte juridike private të akredituara për certifikimin e punonjësve si më poshtë:

Mobilier / Montator 2 (dy)

Marangoz 1 (një)

**Shënim:** Ky kriter do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8 të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t'u kërkuar sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

b. Në rastin kur operatori ekonomik është tregtar (jo prodhues), ai duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi ose nga distributori i autorizuar nga prodhuesi, i cili i jep të drejtën e shitjes së prodhimeve të tij.

**Plotesimi i njerit prej kushteve e bene oferten te vlefshme.**

**Argumentim:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” ndryshuar me ligjin 16/2024 dhe nenit 40, pika 5/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Nga ana e AK është kërkuar një numër punonjesh prej 6 personash, sepse kontrata është komplekse, me shumë artikuj arsimor ku kërkohen punonjes të specializuar si inxhinier druri, marangoz ose punonjes të specializuar druri, shofer dhe punonjes të thjeshtë për ngarkim-shkarkim dhe vendosje në vend të mallrave objekt prokurimi. Shumë artikuj janë prodhim sipas permasave të percaktuara në planet përkatëse të mobilimit që kërkon precizion, cilësi dhe shpejtësi në të njëjtën kohë. Të gjithë artikujt janë parashikuar të jenë Furnizim Vendosje, pra përveç prodhimit dhe shpërndarjes kemi të përfshirë edhe procesin e montimit që kërkon punonjes të tjere duke patur

parasysh edhe faktin qe kemi te bejme me ambiente qe gjenden ne kate te ndryshme te godines se shkolles .

*Në rastin kur operatori ekonomik është tregtar (jo prodhues), ai duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi ose nga distributori i autorizuar nga prodhuesi, i cili i jep të drejtën e shitjes së prodhimeve të tij. Ky kriter është vendosur për të dhene mundesi edhe biznesit te mesem per te marr pjese por sigurisht duke pasuri nje autorizim nga prodhuesi ose nga distributori i autorizuar nga prodhuesi per te garantuar AK ne zbatimin me sukses te kontrates.*

**2.3.3** Operatori ekonomik duhet të disponojë minimum 1(nje) mjete transporti me peshë mbajtëse mbi 1.5 ton të përshtatshëm për transport mallrash. Mjeti i transportit mund të jenë në pronësi ose me qira.

a) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet ;

-dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), certifikaten e kontrollit teknik ,siguracionin e mjetit (te vlefshme), çertifikatë për transport mallrash për nevojat e veta , foto

-per mjetet e siguruara me qera, dokumenti qe verteton regjistrimin e tij ,certifikaten e kontrollit teknik siguracionin e mjetit,(te vlefshme),çertifikatë për transport mallrash për të tretë dhe me qera brenda vendit , kontraten perkatese te qerese/furnizimit, e vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates objekt i ketij prokurimi, foto

b)Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese ku te deklarohet vendndodhja e mjeteve ne pronesi ose me qera me qellim verifikimi. Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet të deklaruara

**Shënim:** Ky kriter do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8 të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t'u kërkuar sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë mjetet dhe pajisjet që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

**Argumentim:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët

ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Referuar specifikimeve të administruar në dosjen e procedurës është përcaktuar se përveç furnizimit të mallit objekt prokurimi do të kryhet transporti dhe vendosja e tyre pranë vend-dorëzimit të tyre në destinacionin përkatës, pra për këtë arsye është e domosdoshme që operatorët e mundshëm ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi mbi pajisjet teknike që kanë në dispozicion për të përmbushur kontratën objekt prokurimi.

Eshtë kërkuar një kamion i pershtatshëm për transport mallrash për të vertetuar që ofertuesit pjesëmarrës kanë automjete e nevojshëm për transportin e mallrave, kapacitetet organizative, aftësitë organizative për të zbatuar kontratën, reputacionin dhe besueshmërinë duke qenë se kontrata është komplekse me shumë artikuj të cilat duhet të transportohen dhe të bëhet furnizim vendosja e tyre sipas shkollave të përcaktuara

#### 2.3.4 Operatori ekonomik duhet të paraqesë :

a) Deklarate me anë të së cilës merr përsipër të kryejë shërbimin e transportit, montimit si dhe vendosjen nëpër vende të të gjithë artikujve në adresat e përcaktuara në planin e shpërndarjes.

b) Deklaratë për periudhën e garancisë së artikujve (jo më pak se 1 vit nga data e dorëzimit të artikujve), gjatë së cilës ofertuesi do të sigurojë riparimin dhe mirëmbajtjen e tyre

**Argumentim:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Ky kriter vendoset në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet pasi mallrat objekt prokurimi duhet të transportohen dhe montohen në të gjithë adresat e përcaktuara në plan shpërndarje.

#### 2.3.5 Operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- Certifikatën e cilësisë së punimeve **ISO 9001- 2015 ose e perditesuar** (e vlefshme, e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë)( *Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zerave të mallarave që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes*).

-Operatori ekonomik vetëm në rastin kur është prodhues duhet të paraqesë Certifikatë **ISO 14001-2015 ose e perditesuar** (e vlefshme, e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë). ( *Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zerave të mallarave që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes*).

Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatë **OHSAS 18001-2007 ose ISO 45001-2018** Për sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë (e vlefshme, e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë). ( *Në rastet e*

*Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zerave të mallarave që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes).*

**Argumentim:** Në bazë të pikës 1 dhe 2, të nenit të 79, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” ndryshuar me ligjin 16/2024 dhe nenit 44, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Nga ana e AK eshte kërkuar zotërimi i certifikatave:

#### **ISO 9001- 2015** - Certifikate e cilesise se punimeve

Duke qenë se objekti i prokurimit në këtë procedurë përfshin pajisjet e mobiljeve për nxënësit e arsimit parauniversitar me qëllim furnizimin me pajisje cilësorë nisur nga fakti që bëhet fjalë për institucione arsimore dhe nisur nga kohëzgjatja e konsiderueshme që përdoren këto pajisje, vlerësohet që zotërimi i një certifikate të tillë është i nevojshëm në përputhje me natyrën dhe volumin e kontratës që prokurohet.

#### **ISO 14001-2015** – Certifikate per menaxhimin e sistemit mjedisor

Duke qenë se objekti i prokurimit në këtë procedurë përfshin prodhimin e pajisjeve të mobiljeve për nxënësit e arsimit parauniversitar dhe duke qenë se ky proces sjell ndikime në mjedis vlerësohet që zotërimi i një certifikate të tillë është i nevojshëm në përputhje me natyrën dhe volumin e kontratës që prokurohet.

#### **ISO 45001-2018** - Certificate per menaxhimin e sistemit te sigurise dhe shendetit

Duke qenë se objekti i prokurimit në këtë procedurë përfshin një sërë procesesh të cilët kërkojnë cilësi dhe operatorët ekonomikë në këtë fushë duhet të zotërojnë një numër të lartë makinerish dhe duhet të kenë të punësuar kryesisht një numër të lartë punonjësish vlerësohet që zotërimi i një certifikate të tillë është i nevojshëm dhe në përputhje të plotë me natyrën dhe volumin e kontratës që prokurohet.

**2.3.6** Operatori ekonomik të paraqesë në gjuhën shqipe, të përkthyer dhe noterizuar katalogë / broshura / foto ilustruese / cdo lloj dokumentacioni tjetër teknik, **për te gjitha** pajisjet e kërkuara duke shënuar në mënyrë të qartë dhe të dallueshme secilin nga pajisjet e ofruara, si dhe të paraqesin mostra në ditën dhe orën e hapjes së ofertave pranë Autoritetit Kontraktor me qëllim që Autoriteti Kontraktor të gjykojë nëse pajisjet e ofruara janë sipas specifikimeve teknike në dokumentet e



tenderit Lista e mostrave qe duhet te paraqiten sipas specifikimeve teknike të dhëna në DST, të jenë:

- Tavolinë nxënësi cikli i ulët
- Karrige nxënësi cikli i ulët:

Mosparaqitja e mostrave në ditën e hapjes së ofertave dhe ne rast se mostrat nuk jane ne perputhje me kerkesat dhe specifikimet teknike sipas DST, perben kusht skualifikues.

Operatori ekonomik për artikujt e kërkuar duhet të paraqesë certifikatat e produktit të shoqëruara me test raportet si më poshtë:

- Tavolinë nxënësi cikli i ulët; SSH/EN 1729-1:2015 (SSH/EN 1729-1:2015/AC:2016); SSH/EN 1729-2:2012+A1:2015, e njëvlefshme ose e përditësuar dhe test raporte.
- Karrige nxënësi cikli i ulët SSH/EN 1729-1:2015 (SSH/EN 1729-1:2015/AC:2016); SSH/EN 1729-2:2012+A1:2015, e njëvlefshme ose e përditësuar dhe test raporte .

Gjithashtu për të gjitha certifikatat e mësipërme, operatori ekonomik mund të paraqesë certifikata ekuivalente ose të përditësuara me ato më sipër, sipas standarteve SSH/EN mbi konformitetin e standarteve europiane dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë.

Çertifikatat e kërkuara duhet të jenë të vlefshme për gjatë periudhës së realizimit të procedurës së prokurimit. Çertifikatat e mesiperme duhet te jene origjinale ose të njehsuara me origjinalin (kopje e noterizuar). Certifikatat e mesiperme duhet te jene te lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Ne rastet kur oferta dorezohet nga nje BOE, operatorët duhet te disponojne certifikatat e kerkuara në përputhje me raportin e pjesëmarrjes në furnizim, të përcaktuara në akt marrëveshje.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 40 pika 6 gërma a), gërma c) dhe pikës 6/b, të nenit të 40 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar me ligjin 16/2024 VKM-së nr.285, datë 19.05.2021”Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar udhezimi nr 03 date 12.04.2022

Vendosja e kriterit të sipërcituara ka për qëllim verifikimin e përputhshmërisë së produkteve të ofruara nga operatorët ekonomikë të interesuar me specifikimet teknike të kërkuara nga Autoriteti Kontraktor me qëllim realizimin e kontratës objekt prokurimi me sukses.

*Qëllimi i vendosur nga ligjvënësi për paraqitjen e mostrave, është dhënia e mundësisë së autoritetit kontraktor, i cili është përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, të kryerjes së verifikimeve (ekzaminim, inspektim, testim) të mostrave të dorëzuar nga operatori ekonomik në rast se këto të fundit janë në përputhje me kerkesat e autoritetit kontraktor të pasqyruar në specifikimet teknike të procedurës së prokurimit. Njësia e Prokurimit gjykon se dorëzimi i mostrave është i rëndësishëm për autoritetin kontraktor në funksion të verifikimit të përputhshmërisë së*

*specifikimeve teknike me mostrat e dorëzuara me qëllim realizimin me sukses të kontratës objekt prokurimi.*

Nga ana e AK janë kërkuar mostra në përputhje me bazën ligjore të sipërpërmendur duke qenë se nëpërmjet kërkesës për dorëzim mostrash AK krijon siguri të plotë dhe vërteton plotësisht përmbushjen e specifikimeve teknike dhe përputhshmërinë e mallrave të kërkuar me ato të ofertuar nga operatori ekonomik.

**Gjithashtu** nga ana e AK janë kërkuar katalogë në përputhje me bazën ligjore të sipërpërmendur duke qenë se nëpërmjet kërkesës për dorëzim e katalogëve AK krijon siguri të plotë dhe vërteton përmbushjen e specifikimeve teknike dhe përputhshmërinë e mallrave të kërkuar me ato të ofertuar nga operatori ekonomik.

Në të gjitha rastet kur përmendet çertifikatë, markë, emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjine specifike, prodhues ose sipërmarrës pranohet edhe ekuivalent i tyre

Në lidhje më afatin e lëvrimit të mallit nga ana specialistit të fushës u vlerësua se nisur nga volumi i kontratës, proceset që do kryhen (prodhim, transport, furnizim vendosje), furnizimi në shkollë në Bashkinë Polican të përcaktuara në plan shpërndarje u caktua afati i lëvrimit prej 30 tridhjetë dite kalendarike nga nënshkrimi i kontratës.

\*\*\*

Për operatorët ekonomikë:

**Shënim:**Mbështetur në përcaktimet e pikës 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, ku parashikohet: *“Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”*, si dhe përcaktimet e pikës 6 dhe 7, të këtij neni, ku parashikohet:

*1. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike . Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.*

*Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike.*

*Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj.*

*Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.*

2. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.**

**Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

## **II. Argumentimi i specifikimeve teknike**

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***

*Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.*

Specifikimet teknike të hartuara nga grupi i punës janë ngarkuar më vete në SPE dhe janë marr nga sipas shkresës nr.1668/36 PROT prot date 27.03.2024 te MAS.

## **FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT**

**Sasia e mallit që kërket**

**Sasia e mallit që kërkohet:**

<b>Nr.</b>	<b>Emërtimi i artikullit</b>	<b>Njësia</b>	<b>Sasia</b>
1	Tavolina nxënësi dyvendëshe (120x64x45cm)	copë	65
2	Karrike nxënësi (35x38x37/70cm)	copë	131
3	Tavolina mësuesi (120x60x76 cm) cikili i lartë,	copë	8

4	Karriqe për mësues me tapiceri (510x450x780 mm)	copë	8
5	Dollap për klasa	copë	8
6	Dërrasë e zezë (120x180 cm)	copë	8
	<b>Kabineti Kimi - Biologji</b>		
1	Tavolina nxenesi për kabinet dyshe 120x60x72 cm	copë	7
2	Tavolina mesuesi per kabinet	copë	1
3	Dollap për kabinetet e kimisë dhe biologjisë	copë	5
4	Karriqe per kabinet	cope	15
	<b>Kabineti Fizikë</b>		
1	Dollap për kabinetet e fizikës	copë	2
	<b>Salla e mësuesve</b>		
1	Tavolinë mbledhjeje e madhe (240x120x75 cm)	copë	6
2	Karriqe për sallën e mësuesve	copë	16
3	Portmonto për dhomën e mësuesve	copë	4
4	Rafte per sallën e mesuesve	copë	2
	<b>Drejtoria</b>		
1	Raft/Dollap për zyra	copë	1
2	Dollap zyre	cope	1
3	Tavolinë drejtuesi në formë L (e madhe)	copë	1
4	Tavoline mbledhje e madhe (240x120x75cm)		
5	Karriqe rrotulluese drejtuesi me rregullim lartësie	copë	1
6	Karriqe zyre e thjeshtë (510x450x780 mm)	copë	6
7	Portmonto për sallën e mësuesve	cope	1
	<b>Biblioteka</b>		
1	Rafte biblioteke	copë	6
	<b>Kabineti Histori-Gjeografi</b>		
1	Dollap për zyra	copë	1

Afatet e lëvrimet: 30 dite kalendarike

**NJESIA E PROKURIMIT :**

**Ferdinand Avdiaj**

**Desantila Zaimi**

**Anisa Cenollari**

